

PROTECT

UDHËZUES TEKNIK

MBI MASAT E SIGURISË FIZIKE PËR MBROJTJEN E INFRASTRUKTURËS KRITIKE NGA SULMET TERRORISTE

Publikim i vitit 2025

Infrastruktura kritike ofron shërbime thelbësore që mundësojnë jetesën e përditshme në të gjithë rajonin e OSBE-së, duke filluar nga uji i pijshëm, energjia dhe elektriciteti, deri te transporti dhe shërbimet bankare. Duke qenë roli i tyre kryesor në një shoqëri, sitet e infrastrukturës kritike kanë qenë historikisht, dhe vazhdojnë të jenë objektivi i organizatave ekstremiste të dhunshme dhe terroriste. Kjo njihet nga Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, të cilat, në Kornizën e Konsoliduar të OSBE-së për Luftën kundër terrorizmit të vitit 2012, i bënë thirrje Organizatës që të vazhdojnë me aktivitete për të rritur bashkëpunimin dhe për të ndërtuar kapacitete për "përmirësimin e sigurisë së transportit ndërkombëtar dhe të infrastrukturave të tjera kritike".¹

Adresimi i këtij kërcënimi të vazhdueshëm, por ende në zhvillim e sipër, është arsyeja pse Projekti PROTECT i OSBE-së hartoi *Udhëzuesin Teknik mbi Masat e Sigurisë Fizike për Mbrojtjen e Infrastrukturrës Kritike nga Sulmet Terroriste*. Ky *Udhëzues Teknik* është një kombinim i përvojës dhe ekspertizës nga i gjithë rajoni i OSBE-së e më gjërë.

Ky Udhëzues Teknik synon të mbështesë Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së dhe pronarët/operatorët e infrastrukturës kritike për t'u përballur drejtpërdrejt me kërcënimin terrorist në zhvillim dhe për të forcuar sigurinë fizike të vendeve të tyre të infrastrukturës kritike. Ai ofron udhëzime të strukturuar mbi praktikën, parimet dhe masat që mund të rrisin sigurinë fizike të vendeve dhe objekteve të përhershme të infrastrukturës kritike, me qëllim parandalimin, përgatitjen më të mirë dhe zbutjen e sulmeve terroriste.



KU MUND TA GJEJ UDHËZUESIN?

Për të marrë Udhëzuesin në gjuhën Angleze dhe Ruse, vizitoni www.osce.org/project/PROTECT ose skanoni QR kodin në vijim. Kopje të printuara vihen në dispozicion për palët e interesuara sipas kërkesës.

¹ Vendimi nr. 1063 i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së për Kornizën e Konsoliduar të OSBE-së për Luftën Kundër Terrorizmit.

PSE NEVOJITET KY UDHËZUES?

Me përjashtim të sektorëve të infrastrukturës kritike shumë të rregulluar, shumë Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së nuk kanë udhëzime të hollësishme mbi masat e sigurisë fizike që duhen zbatuar në nivel të vendit. Ajo që më shpesh ekziston është një koleksion i ndërlikuar praktikash, parimesh dhe dokumentesh udhëzuese jo detyruese, të cilat qeveritë, pronarët/operatorët e infrastrukturës kritike dhe ata me detyra sigurie në objektet e infrastrukturës kritike (përfshirë ofruesit privatë të sigurisë) duhet t'i shqyrtojnë dhe t'i analizojnë për të siguruar siguri fizike efektive për vendet dhe objektet nën kujdesin e tyre.

Në vend që të diktojë një qasje të vetme ndaj sigurisë fizike, ky Udhëzues paraqet një gamë praktikash, publikisht në dispozicion, që pasqyrojnë qasjet e ndryshme që ekzistojnë aktualisht. Shumica e praktikave të cituara në këtë Udhëzues vijnë nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, kështu duke dëshmuar praninë e një pasurie të madhe të njohurive tek anëtarësia e OSBE-së.

PËR KË ËSHTË UDHËZUESI?

Siguria fizike efektive në objektet e infrastrukturës kritike kërkon angazhim dhe përkushtim nga një gamë e gjerë aktorësh:

- **Politikëbërësit e lartë qeveritarë dhe pronarët/operatorët e lartë të infrastrukturës kritike:** Edhe pse nuk janë zbatuesit e drejtpërdrejtë të masave të sigurisë fizike në nivelin e vendit të infrastrukturës kritike, politikëbërësit qeveritarë ofrojnë kornizën ligjore dhe strategjike mbi të cilën ndërtohet siguria fizike efektive. Informacione që mund të jenë veçanërisht të vlefshme për ta gjenden në Kapitullin 2 mbi Kornizat Strategjike dhe Ligjore për Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike, në Kapitullin 3 mbi Konsideratat për të Drejtat e Njeriut, dhe në Kapitullin 4 mbi Partneritetet Publiko-Private.
- **Praktikuesit teknik me detyra nga fusha e sigurisë fizike:** Udhëzuesi ofron një kornizë strategjike esenciale për misionet e sigurisë fizike në Kapitujt 1 deri në 3. Kapitujt 5 deri në 10 sigurojnë përshkrime të detajuara të politikave, studimeve të rasteve dhe praktikave nga jeta reale që rrisin sigurinë fizike në një gamë të gjerë vendesh të ndryshme të infrastrukturës kritike.

ÇFARË PËRFSHIHET NË UDHËZUES?



Kapitulli

- 1 Hyrje
- 2 Kornizat Strategjike dhe Ligjore për Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike
- 3 Konsiderata për të Drejtat e Njeriut
- 4 Partneritetet Publiko-Private
- 5 Vlerësimi i Kërcënimit dhe Rrezikut nga Terrorizmi
- 6 Masat e Sigurisë Fizike
- 7 Planifikimi i Sigurisë dhe Përforsimi i Objektivave
- 8 Menaxhim i Kërcënimeve nga Brenda
- 9 Trajnimi dhe Ushtrimet
- 10 Opsione të Përmirësuar të Përshkallëzimit të Kërcënimit

DETAJE TË MËTEJSHME

Nëse dëshironi të mësoni më shumë për *Udhëzuesin Teknik* ose Projektin PROTECT, dërgoni një e-mail te Njësia e Veprimit Kundër Terrorizmit në Departamentin e Kërcënimeve Transnacionale të Sekretariatit të OSBE-së në atu@osce.org.

FINANCUESIT

Projekti PROTECT financohet nga Byroja e Kundërterrorizmit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republika Federale e Gjermanisë.